

Nail Isufi, PhD¹

UDC: 341.73

**PËRFUNDIMI I IMUNITETEVE DHE PRIVILEGJEVE
DIPLOMATIKE DHE KONSULLORE**

**ПРЕСТАНОК НА ДИПЛОМАТСКИ И КОНЗУЛАРНИ
ИМУНИТЕТ И ПРИВИЛЕГИИ**

**THE TERMINATION OF DIPLOMATIC AND CONSULAR
IMMUNITY AND PRIVILEGES**

Abstract

The importance and role of diplomatic immunity and privileges are recognized both in international law and domestic law of states. In this regard, the topic in question is crucial due to the international conventions and positive laws that address it. Thus, the issue of terminating diplomatic and consular immunities and privileges has been discussed by numerous international and national authors.

The purpose of this paper is to address the cases of the termination of diplomatic and consular immunities and privileges in a more comprehensive manner, in accordance with the conventions that address with the matter in question, i.e. the Vienna Convention on Diplomatic Relations, 1961 and the Vienna Convention on Consular Relations, 1963.

It is crucial to note that in addition to the existing recognized international laws, there are still instances where the internal laws of the states are needed to intervene, specifically through bilateral agreements.

Keywords: *diplomat, consul, convention, immunity.*

¹ Doktor i Shkencave Juridike, Universiteti "Nënë Tereza", Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut. E-mail: nail87@hotmail.com

1. Përfundimi i imuniteteve dhe privilegjeve diplomatike

1.1 Imuniteti në rast të përfundimit të marrëdhënieve diplomatike

Në rast se vjen deri te ndërprerja e marrëdhënieve diplomatike, por edhe në rast të konfliktit të armatosur, shteti pritës është i obliguar që të respektojë imunitetin edhe në rastet e përfundimit të funksioneve të përfaqësuesve diplomatik. Përveç kësaj Konventa e Vjenës parasheh edhe në rastet konfliktit të armatosur të kenë lehtësime dhe t'u bëhet e mundur që edhe këta persona të cilët gëzojnë privilegje dhe imunitet të lëshojnë vendin në afat sa më të shkurtër kohor. Gjithashtu, shteti pritës është i obliguar që në rast nevoje t'u lë në dispozicion edhe mjetet transportuese.² Prandaj, shteti pritës në rastet e konfliktit të armatosur obligohet që të jep lehtësime që t'ua bëjë të mundur personave të cilët gëzojnë privilegje dhe imunitet, përveç shtetasve të shtetit pritës si dhe anëtarëve të familjes së tyre pavarësisht shtetësisë së tyre që të lëshojnë vendin në afat sa më të shkurtër kohor.³

Në rast të ndërprerjes së marrëdhënieve diplomatike midis dy shteteve ose në rast se ndonjë mision është tërhequr përfundimisht ose përkohësisht, atëherë:⁴

- Shteti pritës është i obliguar që në rast të konfliktit të armatosur, të respektojë hapësirat e mbrojtura të misionit së bashku me pronën dhe arkivin e saj;

- Shteti dërgues ka mundësinë që t'ia besojë ruajtjen e hapësirave të misionit si dhe pronën që gjendet në të së bashku me pronën dhe arkivin e saj, ndonjë shteti të tretë me pëlqimin e shtetit pritës;

- Shteti dërgues ka mundësinë që t'ia besojë mbrojtjen e interesave të shtetasve të saj, ndonjë shteti të tretë me pëlqimin e shtetit pritës.

1.2 Përfundimi i marrëdhënieve diplomatike me marrëveshje

Marrëdhëniet diplomatike midis dy shteteve gjithashtu mund të përfundojnë edhe në mënyrë miqësore, sipas marrëveshjes. Siç është vërejtur, secili shtet sovran dhe i pavarur gëzon të drejtën e legacionit,

² Марковски, Д. Дипломатија-организација и практика (material në dorëshkrim), Скопје, 2016, f. 248- 249.

³ Konventa e Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike, 1961, neni 44.

⁴ Neni 45, pika 1-3.

d.m.th. të vendosë marrëdhënie diplomatike me të gjitha shtetet e tjera sovrane, por se krijimi i marrëdhënieve të tilla në fakt bëhet në bazë të marrëveshjes si dhe duke pasur parasysh numrin e madh të shteteve të pavarura në botë, shtetet e sotme nuk e kanë të lehtë ose praktike që të kenë misione në të gjitha kryeqytetet. Është e mundur që një shtet pasi të vendosë një mision diplomatik në një shtet të caktuar, më vonë të cilësoj atë si të panevojshme ose joekonomike duke pasur parasysh zvogëlimin e interesit për mbrojtjen e misionit të tillë. Në rrethanat e këtilla, shtetet në fjalë kanë mundësi që të bien dakord për të ndërprerë misionet e tyre diplomatike dhe misionet e agentëve diplomatik të shteteve në fjalë përfundojnë automatikisht.⁵

1.3 Imuniteti për shkak të shkarkimit të përfaqësuesit diplomatik

Ekzistojnë disa raste në të cilat shtetet kanë kërkuar që ndonjë përfaqësues i caktuar diplomatik të largohet nga shteti pritës duke mos pritur tërheqjen e tij nga shteti dërgues i përfaqësuesit diplomatik. Një hap i tillë mund të merret vetëm kur një përfaqësues shpërfill në mënyrë serioze dhe flagrante detyrimet e tij. Nuk është e nevojshme që t'u referohemi rasteve të shekujve XVI dhe XVII, pasi në kohën moderne është e paimagjinueshme që të gjendet ndonjë përfaqësues duke komplotuar kundër jetës së sovranit ose duke marrë pjesë në ndonjë komplot për të përmbysur qeverinë. Siç është e njohur shtetet u kanë kërkuar diplomatëve që të largohen menjëherë në raste të caktuara serioze. P.sh. në vitin 1916 ministrat gjermanë dhe austro-hungarezë në Athinë u urdhëruan që të largoheshin nga Greqia me anëtarët e stafit të tyre për veprime të paligjshme spiunazhi të kryera nga shteti grek. Në vitin 1917, Count Luxburg, ministër gjerman në Buenos Aires, ngjalli zemërim të madh në Republikën Argjentinase nga dredhitë e tij kundër interesave argjentinase. Qeveria e Argjentinës i dërgoi pasaportat e tij duke e informuar njëkohësisht se ai nuk ishte më *persona grata*. Rustem Bey, ambasadori turk në Shtetet e Bashkuara, u dërgua në vendin e tij në fillim të luftës 1914-1918 për shkak të botimit të pamatur të gazetave dhe revistave. Në vitin 1941, për shkak të fakteve dhe rrethanave të ndryshme të cilat kishin të bëjnë me atasheun detar italian me kryerjen e veprimeve të cilat ishin në kundërshtim me ligjet e Shteteve të

⁵ Sen. B. A. Diplomat's Handbook of International Law and Practice, The Hague, 1965, f. 185.

Bashkuara, të cilat më pas morën vëmendjen e qeverisë amerikane, pas së cilës atashut iu kërkua të largohesh nga shteti.⁶

Viteve të fundit kërkesat për tërheqjen e përfaqësuesve diplomatik janë bërë edhe në baza thjeshtë hakmarrëse. P.sh. kur një shtet kërkon tërheqjen e një diplomati nga shteti tjetër për shkak të veprimeve të pakëndshme të këtij të fundit. Prandaj, kjo ka qenë si rezultat i Luftës së Ftohtë dhe mund të thuhet se nuk është gjë tjetër veçse abuzim me të drejtën e një shteti për të kërkuar tërheqjen e një përfaqësuesi diplomatik sipas dëshirës së tij. Megjithatë, është e padrejtë ndaj diplomatit tërheqja e të cilit kërkohet në rrethanat e tilla, për arsye se një hap i tillë ndikon mbi vetë diplomatin.⁷

1.4 Imuniteti në rast të dorëheqjes së përfaqësuesit diplomatik

Qëllimi i imunitetit diplomatik është që të sigurojë kryerjen efektive të funksioneve të misionit diplomatik dhe se nuk është për përfitime personale. Prandaj, imuniteti diplomatik nuk mund t'i hiqet në çdo kohë personit i cili e gëzon atë. Ai mund të heq dorë vetë ose në emër të shtetit dërgues.⁸ Nga ana tjetër edhe në Konventën e Vjenës, është paraparë që: *“heqja dorë nga imuniteti duhet të jepet çdoherë shprehimisht”*.⁹ Ligji i shtetit pritet duhet të përcaktojë nëse imuniteti është hequr dhe duhet pasur kujdes të veçantë në procedurat penale, për shkak se diplomati i akuzuar mund të kontestojë heqjen dorë. Heqja dorë nga imuniteti nga ana e shefit të misionit zakonisht konsiderohet si valide, përveç nëse nuk vërtetohet imuniteti personal i tij dhe se shumica e qeverive kërkojnë nga shefi i misionit që t'i qaset autoritetit të tij para se të heq dorë nga imuniteti i ndonjërit prej stafit të tij.¹⁰ Rast konkret kemi p.sh. në Statutin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare për Ruandën, gjykata nuk mund të procesojë ndonjë kërkesë për dorëzim ose nga e cila do të kërkohet nga shteti si kërkues që të veprojë në kundërshtim me detyrimet e tij, sipas të drejtës ndërkombëtare në lidhje me shtetin ose imunitetin diplomatik të një personi ose prone të një shteti të tretë, në rast se gjykata së pari arrin bashkëpunimin me shtetin e tretë për heqjen dorë nga imuniteti.¹¹

⁶ Po aty, f. 191.

⁷ Po aty, f. 192-193.

⁸ Aust, A. Handbook of International Law, Cambridge, 2010, f. 130.

⁹ Konventa e Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike, 1961, neni 32, pika 2.

¹⁰ Aust, A. Handbook of International Law, Cambridge, 2010, f. 130-131.

¹¹ Grant, J. P. & Barker, J. C. International Criminal Law Deskbook, Sydney & London, 2006, f. 232, 288.

1.5 Imuniteti për shkak të shpalljes së personit të padëshiruar - Persona non grata

Ashtu siç është vërejtur më herët, qeverisë së shtetit pritës i është lënë mundësia që të shpallë ndonjë diplomat *persona non grata* madje edhe në rastet pas pranimit të tij. Pas deklaratës së tillë, diplomatit i përfundojnë funksionet në atë shtet dhe ai është i obliguar që të lëshojë shtetin.¹²

Prandaj, shteti pritës ka mundësi që në çdo kohë dhe duke mos dhënë arsyetime për vendimin e marrë të njoftojë shtetin dërgues se shefi i misionit ose ndonjë anëtarë i stafit diplomatik të misionit është *persona non grata* ose ndonjë anëtarë i stafit të misionit është i padëshiruar. Në rastet e këtilla, shteti dërgues do të tërheq personin e caktuar ose do të përfundojë funksionin e tij brenda misionit. Gjithashtu, ekzistojnë rastet që ndonjë person të shpallet *persona non grata* ose i padëshiruar para se të arrijë në territorin e shtetit pritës.¹³

1.6 Prezantimi i kredencialeve të reja

Misioni i diplomatit konsiderohet që ka përfunduar atëherë kur rrethanat kërkojnë paraqitjen e letrave të reja kredenciale, siç është rasti kur ndodhë vdekja e sunduesit sovran të shtetit pritës ose të shtetit dërgues. Meqenëse letrat kredenciale jepen dhe i drejtohen sovranit në shtetet në të cilat ekziston forma monarkike e qeverisjes, atëherë vdekja e sovranit sjellë edhe përfundimin e misionit të diplomatit i cili ishte ngarkuar sipas letrave kredenciale, sepse kredencialet konsiderohen se kanë përfunduar me vdekjen e sovranit të shtetit dërgues ose të shtetit pritës. Kredencialet e reja që i paraqet agjenti diplomatik konsiderohen se përbëjnë misionin e ri, ndonëse në praktikën moderne diplomatike paraqitja e kredencialeve të reja në rrethana të tilla nuk ndikon në përvojën e shefit të misionit ose në marrëdhëniet e tij të zakonshme me autoritetet e shtetit pritës. Gjithashtu, mund të përmendet që vdekja e presidentit të një republike ose dalja e tij në pension nuk paraqet nevojën për paraqitjen e kredencialeve të reja. Rast tjetër kemi kur misioni ka përfunduar, d.m.th. është kur statusi i misionit ngrihet nga një legatë në një ambasadë. Në rastin e këtillë, shefi i legatës, i cili është caktuar si ministër, duhet të paraqesë letrat e reja kredenciale përpara se të

¹² Sen. B. A. Diplomat's Handbook of International Law and Practice, The Hague, 1965, f. 44.

¹³ Konventa e Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike, 1961, neni 9.

marrë detyrën e shefit të ambasadës së shtetit të tij. Nga momenti i ngritjes së statusit të misionit që hynë në fuqi, mandati i ministrit konsiderohet i përfunduar. Pra, ai ngrihet në mision të ri në rastet kur paraqet letrat kredenciale si ambasador.¹⁴ Përkundrazi, sot vdekja e kryetarit ose shefit të shtetit ose përfundimit të mandatit të tij nuk e detyron misionin diplomatik të kërkojë ose të dorëzojë letra të reja kredenciale. Në rast se nuk janë të patjetërsueshme letrat kredenciale, atëherë është e nevojshme që të dërgohet një letër zyrtare me të cilën do të vërtetohen autorizimet. Sidoqoftë, shefi i misionit i disponon dhe gëzon të gjitha autorizimet për bisedime me shtetin pritës.¹⁵

Ashtu siç përmendëm pak më lartë, në rast se kreu (kryetari) i shtetit pritës vdes ose i mbaron mandati, ambasadorët nuk e kanë të nevojshme t'i paraqesin letra kredenciale atij që e zëvendëson. E njëjta gjë vlen edhe nëse kreu i shtetit dërgues vdes apo i mbaron mandati dhe në vend të tij pason dikush tjetër. Letrat kredenciale, kryesisht paraqiten vetëm njëherë dhe ky akt lidhet, në fakt, më shumë me institucionin e kreut të shtetit, sesa me personin si subjekt. Prandaj, vlera e letrave kredenciale nuk skadon për aq kohë sa shteti pritës dhe shteti dërgues i kanë dhënë përfaqësim fuqplotë ambasadorit.

Natyrisht, edhe pse nuk paraqiten letra të reja kredenciale, është normë diplomatike që ambasadori, menjëherë kur kreu i ri i shtetit pritës merr detyrën, nëpërmjet protokollit shtetëror, kërkon takim formal. Në këtë takim, ai (ose ajo) e uron kreun e shtetit mik në të cilin po kryen shërbimin diplomatik dhe i ofron bashkëpunim të ngushtë edhe në emër të shtetit që e dërgon. Në përgjithësi, është normë diplomatike që kreu i shtetit që ka dërguar ambasadorin në shtetin pritës ku ka pasur ndryshime të drejtimit të shtetit, i jep ambasadorit (me postë, etj.) një kopje të letrës që i ka dërguar si urim homologut të tij. Kjo letër, e cila mund të ketë mbërritur si njoftim edhe më herët tek kreu i shtetit pritës nga kanale diplomatike të tij, gjithsesi, kur i jepet në dorë nga ambasadori, konsiderohet si “*rinovim*” i letrave kredenciale dhe garanci për vijueshmërinë e bashkëpunimit mes dy vendeve. Gjithashtu, në këto takime, shihet se kush e ka radhën për të kryer vizitën e nivelit të lartë dhe ambasadori udhëzohet që të përsërisë ftesën për kreun e shtetit pritës ose në të kundërt, shpreh me finesë gatishmërinë e kreut të shtetit të tij

¹⁴ Sen. B. A. Diplomat's Handbook of International Law and Practice, The Hague, 1965, f. 183-184.

¹⁵ Вуд. Џ. П. & Серес. Џ. Дипломатски церемонијал и протокол, Скопје, 2009, f. 53.

për të bërë një vizitë në vendin ku ai shërben dhe ku ka ndodhur edhe ndryshimi i kreut të shtetit.¹⁶

1.7 Ndryshimet revolucionare në qeveri

Në rast të ndryshimeve revolucionare në qeverinë e shtetit dërgues ose në qeverinë e shtetit pritës, atëherë paraqitja e kredencialeve të reja është e nevojshme dhe se misioni ekzistues përfundon. E njëjta gjendje do të ishte kur ndryshohet forma e qeverisjes, siç është kur një monarki bëhet republikë ose kur një republikë bëhet monarki respektivisht, me rivendosjen e monarkisë.¹⁷ Është rregull, që shefi i ri i misionit të mos vijë deri sa paraardhësi i tij nuk e lëshon shtetin në të cilin është i akredituar.¹⁸

Atëherë, kur kreu i shtetit në shtetin pritës është ndërruar me revolucion, në përgjithësi tërhiqet ambasadori që ka shërbyer në atë vend dhe ai zëvendësohet me një diplomat tjetër. Kjo, për shkak se ambasadori duhet të ketë besimin e drejtuesve të rinj që kanë qenë në konflikt me ata që janë larguar nga pushteti si pasojë e dhunës. Por, në rastet kur drejtuesit e rinj revolucionar, japin shenja se nuk kanë problem të punojnë me një ambasador që ka qenë edhe gjatë kohës së revolucionit, kjo nuk përbën problem dhe nuk ka nevojë për të paraqitur letra të reja kredenciale. Gjithsesi, rekomandohet që në rast ndryshimesh të tilla, së paku ambasadorët duhen nderuar, sepse edhe shteti pritës ku kanë ndodhur ndryshime radikale i nderon përfaqësuesit e vet kudo në botë. Pra, në këto raste vihet në lëvizje mekanizmi i “*reciprocitetit*”. Në raste të tilla, të ngarkuarit me punë, janë ata që qëndrojnë në detyrë derisa shtetet të rivendosin marrëdhëniet në nivelet që ishin dhe kjo fillon që nga deklarata e njohjes apo mosnjohjes së qeverisë së re që mund të ketë ardhur si pasojë e një revolucioni apo ndryshimi sistemi me votim. E njëjta gjë ka kuptim edhe për ngjarje dhe ndryshime që mund të ndodhin në shtetin dërgues të ambasadorit. Letrat kredenciale për ambasadorin jepen vetëm njëherë dhe ato nuk rinovohen pse ndërrohet kreu i shtetit, por thjeshtë veprohet si në pikën më lartë, në takimin formal paraqitet një mesazh, ftesë, letër, etj., nga kreu i shtetit dërgues për kreun e ri të shtetit pritës dhe mjafton.

¹⁶ Shënime nga intervista me ish-ambasadorin Arben Çejku, të realizuar në datën: 03.02.2022.

¹⁷ Sen. B. A. *Diplomat's Handbook of International Law and Practice*, The Hague, 1965, f. 184.

¹⁸ Вуд. Ц. П. & Серес. Ц. *Дипломатски церемонијал и протокол*, Скопје, 2009, f. 53.

Letrat kredenciale janë pjesë e rëndësishme e protokollit të instalimit të një ambasadori dhe ato mbesin të tilla deri kur ambasadorit i përfundon mandati apo, për arsye ekstreme (të tij apo marrëdhënieve mes shtetit ku është dhe shtetit që përfaqëson) shpallet “*persona non grata*” dhe duhet të largohet sipas afatit të dhënë nga ministria e jashtme e shtetit pritës.¹⁹

1.8 Shuarja e shtetit dërgues ose pritës

Misioni i një diplomati mund të përfundojë edhe me shuarjen e shtetit dërgues ose pritës. Në raste të tilla marrëdhëniet diplomatike midis dy vendeve pushojnë së ekzistuari dhe misioni i agjentit diplomatik përfundon me të. Mbajtja e marrëdhënieve diplomatike presupozon ekzistencën e dy shteteve sovrane të pavarura. Nëse një nga shtetet sovrane humb identitetin e tij duke u pushtuar ose duke u bashkuar me një shtet më të madh ose duke u formuar në një bashkim me një shtet tjetër, marrëdhëniet diplomatike me atë shtet duhet të përfundojnë automatikisht dhe së bashku me të edhe misioni i diplomatëve të atij shteti në vende të tjera pasi edhe misioni i diplomatëve të akredituar në atë shtet do të përfundonte.²⁰ Megjithatë, përjashtimet nga ky rregull janë bërë kur shtetet e konsideronin zhdukjen e një shteti tjetër thjeshtë sikur të jetë i një natyre të përkohshme. P.sh. gjatë Luftës së Dytë Botërore, kur ushtria gjermane ishte në përparim gjatë pushtimit thuajse të gjithë Evropës Perëndimore, Britania dhe Shtetet e Bashkuara vazhduan të mbanin marrëdhënie me qeveritë e atyre shteteve të cilat ata i konsideronin si qeveri *de jure* të Evropës ose shtetet nën dominimin nazist. Në këto raste misioni i agjentëve diplomatik të akredituar në ato vende nuk u konsiderua se ishte në përfundim. Sidoqoftë, këto raste janë më shumë të natyrës përjashtuese të bëra dhe që ishin në interes të nevojave politike të asaj kohe. Kur Etiopia ra nën sundimin italian në vitin 1936, marrëdhëniet diplomatike me atë vend u përfunduan dhe përsëri në vitin 1958 kur Siria u bashkua me Egjiptin për të formuar Republikën e Bashkuar Arabe, marrëdhëniet diplomatike midis tyre përfunduan si rezultat i krijimit të shtetit të ri të formuar nga bashkimi.²¹

Sidoqoftë, në qoftë se ndodhë zhdukja e njërit shtet (pritës apo ai që e ka dërguar) bashkë me të shlyhet edhe vlera e letrave kredenciale.

¹⁹ Shënime nga intervista me ish-ambasadorin Arben Çejku, të realizuar në datën: 03.02.2022.

²⁰ Sen. B. A. Diplomat's Handbook of International Law and Practice, The Hague, 1965, f. 184.

²¹ Po aty, f. 185.

P.sh. nëse Krimea do të ishte një shtet i caktuar, në momentin që ajo është aneksuar nga Rusia, bashkë me institucionin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Krimesë, janë devaluuar edhe kredencialet e diplomatëve të huaj, të cilët, bazuar në udhëzimet e shtetit të tyre, largohen nga vendi ku kanë shërbyer. Diplomatët e ruajnë imunitetin e tyre diplomatik në territorin ku kanë shërbyer derisa të largohen nga ky vend, nën përkujdesjen e atyre forcave që kanë marrë përgjegjësinë për sigurinë e territorit. Por, nga ana tjetër, nëse për arsye të caktuara, shteti dërgues del jashtë funksionit dhe nuk ka asnjë lloj sovraniteti, atëherë diplomati (qoftë dhe ambasadorë), bën një njoftim dhe kërkon takim në protokollin e shtetit ku po shërben. Në atë takim, ambasadori (i ngarkuari i përkohshëm me punë), apo ai që ka gradën më të lartë në mision, njofton shtetin pritës për situatën që ka ndodhur në vendin e tij dhe kërkon mbrojtje diplomatike për stafin dhe objektin, duke njoftuar pezullimin e veprimtarisë diplomatike. Si rregull, diplomatët duhet të kthehen në vendin e tyre, pavarësisht se ai mund të jetë bërë pjesë e një shteti tjetër apo të jetë ndarë në disa shtete. Ambasadori duhet që t'ia dorëzojë ambasadën një të dërguari të shtetit të tij ose nëse situata është e paqartë, duhet të qëndrojë në detyrë formalisht, duke mos qenë aktiv në jetën diplomatike. Kjo, sepse atij i mungojnë udhëzimet nga qendra dhe nuk mund të dalë nëpër takime me mendimet dhe idetë e tij personale. Në shumicën e rasteve, diplomatët kanë kërkuar strehim në shtetin pritës dhe dokumentacioni është konservuar diku derisa të interesuarit dhe zyrtarë të caktuar e kanë tërhequr për nevoja arkivore dhe historike, kur situata është qartësuar.²²

1.9 Imuniteti për shkak të konfliktit të armatosur

Marrëdhëniet diplomatike pa dyshim që përfundojnë si rezultat i shpërthimit të luftës dhe më së shpeshti para fillimit të armiqësive aktuale, për arsye se marrëdhëniet duhet të arrijnë në gjendje të tillë që asnjë qëllim i dobishëm të mos shërbehet nga mbajtja e këtyre marrëdhënieve. Mund të përmendet se marrëdhëniet diplomatike përfundojnë kur ekziston gjendje lufte, e cila fillon me shpalljen e luftës dhe pushon në bazë të një traktati paqeje. Përveç gjendjes së luftës, mund të ketë konflikte midis shteteve, por konflikte e tilla nuk u japin fund në mënyrë të domosdoshme marrëdhënieve diplomatike. P.sh. midis viteve 1932

²² Shënime nga intervista me ish-ambasadorin Arben Çejku, të realizuar në datën: 03.02.2022.

dhe 1941 Kina dhe Japonia ishin përfshirë në konflikte të armatosura, por nuk kishte gjendje luftarë. Marrëdhëniet diplomatike vazhduan deri në vitin 1938 dhe lufta ishte shpallur në vitin 1941.²³

Është me rëndësi të theksohet dhe njëherit që është në interes të paqes botërore dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare se marrëdhëniet diplomatike duhet të vazhdojnë, sepse mungesa e marrëdhënieve të tilla e vështirëson mbajtjen e lidhjeve. Një gjë e tillë po ndodhë edhe më shumë në ditët e sotme, pasi është e qartë se rastet e ndërprerjes së marrëdhënieve diplomatike kanë përfunduar si rezultat i incidenteve të caktuara, madje edhe për shkak të politikave të përgjithshme të udhëhequra nga qeveritë janë reduktuar shumë. Mund të përmendet rasti pas incidentit U-2 në të cilin Bashkimi Sovjetik nuk i shkëputi marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara, bile as edhe shtetet e tjera nuk i ndërprejnë marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik, pavarësisht të disave incidenteve të spiunimit.²⁴

Sidoqoftë, kur ka konflikt të armatosur në shtetin pritës, diplomati (përfshirë ambasadorin) mban kontakt vetëm me protokollin e shtetit pritës duke shmangur aktivitetin e tij diplomatik. Ai zbaton vetëm udhëzimet e ministrisë së tij të jashtme dhe të shtetit pritës. Në raste evakuimi të kërkuar nga shteti pritës, ambasadori duhet të marrë masa për zbatim rigoroz të urdhrave për të siguruar jetën stafit dhe familjarëve të tyre.

Ambasadori nuk shkëmben kredenciale të asnjë forme me palët ndërluftuese dhe qëndron asnjëherë, pa dhënë deklarata. Edhe nëse flet, duhet të nxit pajtimin dhe dialogun. Një ambasador asnjëherë nuk duhet të shpreh qëndrime luftënxitëse dhe të njëanshme.

Kur pas një konflikti të armatosur, kemi qeveri të re, atëherë në konsultim me protokollin e shtetit pritës, bëhen hapat e duhura. Në çdo rast, rinovimi i kredencialeve nuk bëhet me një letër kredenciale dhe me ceremoni të përsëritur, por pranohet ambasadori ashtu siç është ose jepet mesazh që njëra nga palët kërkon ambasadorë të ri.

Edhe në rastet kur shtete e caktuara apo kryetar shtetesh të caktuara kërkojnë letra kredenciale nga ambasadori në detyrë, kjo nuk duhet konsideruar si skandal diplomatik, por si një formë për të rivendosur bashkëpunimin mbi bazën e besimit reciprok. Nëse fjala vjen, shteti pritës kërkon këtë akt diplomatik, e njëjta duhet të bëhet edhe nga shteti dërgues, në diplomaci prevalon reciprociteti.

Sistemi diplomatik botëror, bazohet kryesisht në Konventën e Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike. Por, ka vende dhe tradita që

²³ Sen. B. A. Diplomat's Handbook of International Law and Practice, The Hague, 1965, f. 194.

²⁴ Po aty, f. 195.

duhen mirëkuptuar, gjithnjë në funksion të vendosjes dhe zhvillimit të marrëdhënieve të shkëlqyera dypalëshe. Duhet të kihet parasysh se nëse kërkesa për rinovim të kredencialeve u bëhet të gjithë ambasadorëve, atëherë kjo nuk duhet refuzuar. Por nëse kjo bëhet mbi baza selektive, kjo duhet trajtuar mbi baza të rrepta të reciprocitetit. Nga eksperiencia, nuk ka ndodhur që të kërkohej letra kredenciale dy herë nga i njëjti ambasador, por gjithmonë duhet pasur në konsideratë si mundësi teorike.

Për fund, nëse ju si ambasadorë, keni kryer shërbim në shtetin X për një mandat të plotë dhe jeni kthyer në atdhe, për rrethana të caktuara, shteti juaj mendon t'ju rikthejë në këtë shtet edhe për një mandat tjetër, sigurisht që duhet të paraqisni letrat kredenciale dhe duhet të bëni çdo hap që parashikon protokollin e shtetit pritës, njësoj sikur keni shkuar herën e parë.

Si rregull, nga njëri mandat tek tjetri, duhet të kenë kaluar së paku 6 muaj, ku një i ngarkuar me punë, ka përfaqësuar shtetin dhe ka drejtuar misionin diplomatik.²⁵

1.10 Imuniteti në rast të vdekjes së përfaqësuesit diplomatik

Misioni i përfaqësuesit diplomatik përfundon me vdekjen e tij. Në rast se ai vdes gjatë ushtrimit të funksionit të tij dhe njëkohësisht duke zotëruar imunitetet dhe privilegjet e tij, atëherë mbetet që shteti pritës të organizojë funeralin e tij me ceremoni të plota dhe të lejojë që trupi i tij të dërgohet në shtetin e tij në rast se këtë e kërkojnë anëtarët e familjes së tij ose qeveria e tij. Gjithashtu, shteti pritës është i obliguar që të lejojë hapësirë të plotë për heqjen e sendeve të tij personale dhe të lehtësojë largimin e anëtarëve të familjes së tij.²⁶ Në këtë drejtim mund të përmendim që anëtarët e familjes së tij do të vazhdojnë të gëzojnë imunitetet dhe privilegjet e tyre për të cilat janë të autorizuar deri në përfundimin e afatit të arsyeshëm në të cilin duhet të lëshojnë shtetin pritës.²⁷

Nëse misioni përfundon me vdekjen e përfaqësuesit diplomatik i cili është shefi i misionit, në të kaluarën ishte zakon që të bëhej funeral publik për nder të tij. Ndërsa, sot ata meritojnë të gjitha organizimet ceremoniale të respektit me të cilin tregohet karakteri i përfaqësuesit-të ndjerit dhe është e zakonshme që të marrin pjesë në varrim anëtarët e trupit diplomatik si dhe zyrtarë të lartë të shtetit.²⁸

²⁵ Shënime nga intervista me ish-ambasadorin Arben Çejku, të realizuar në datën: 03.02.2022.

²⁶ Sen. B. A. Diplomat's Handbook of International Law and Practice, The Hague, 1965, f. 197.

²⁷ Konventa e Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike, 1961, neni 39, pika 3.

²⁸ Sen. B. A. Diplomat's Handbook of International Law and Practice, The Hague, 1965, f. 197.

2. Përfundimi i privilegjeve dhe imuniteteve konsullore

2.1 Imuniteti në rast të përfundimit të marrëdhënieve konsullore

Funksionet konsullore pushojnë me ndërprerjen e marrëdhënieve konsullore. Kjo rregullisht ndodhë në rast lufte midis dy shteteve. Në raste të tilla shteti pritës duhet t'i mbrojë lokalet konsullore, pasurinë dhe arkivin. Shteti dërgues mund t'ia besojë ruajtjen e tyre dhe mbrojtjen e interesave të veta dhe shtetasve të tij ndonjë shteti të tretë, nëse për këtë pajtohet edhe shteti pritës.²⁹ Prandaj, ndërprerja e marrëdhënieve diplomatike *ipso facto* nuk përfshinë edhe ndërprerjen e marrëdhënieve konsullore.³⁰ Nga ana tjetër, ndërprerja ose mungesa e marrëdhënieve diplomatike ose konsullore midis dy ose më shumë shteteve nuk e pengon lidhjen e marrëveshjeve midis shteteve të tilla. Nga ana tjetër, lidhja e marrëveshjeve vetvetiu nuk e cenon situatën në lidhje me marrëdhëniet diplomatike ose konsullore.³¹

2.2 Imuniteti për shkak të shpalljes së personit të padëshiruar - *Persona non grata*

Lidhur me shpalljen e personit të padëshiruar ose *persona non grata* Konventa e Vjenës mbi Marrëdhëniet Konsullore ka paraparë që shteti pritës të mund të njoftojë shtetin dërgues që ndonjë zyrtar konsullor është *non grata* ose ndonjë anëtar i personelit konsullor nuk është i pranueshëm. Në këtë rast, shteti dërgues ka mundësi që të shkarkojë personin në fjalë ose do të përfundojë funksionet e tij në postin konsullor.³²

Në rast se shteti dërgues refuzon ose nuk përmbush detyrimet e veta brenda afatit të arsyeshëm, shteti pritës ka mundësi që në përputhje me rrethanat të tërheq ekzekvaturën për personin në fjalë ose të pushojë ta konsiderojë atë si anëtarë i personelit konsullor.³³

Personi i emëruar si anëtarë i ndonjë posti konsullor mund të shpallet si i papranueshëm edhe para arritjes së tij në shtetin pritës ose nëse edhe tashmë gjendet në territorin e shtetit pritës para se të marrë

²⁹ Gruda, Z. E drejta ndërkombëtare publike, Prishtinë, 2003, f. 241.

³⁰ Konventa e Vjenës mbi Marrëdhëniet Konsullore, 1963, neni 2, pika 3.

³¹ Konventa e Vjenës mbi të Drejtën e Traktateve, 1969, neni 74.

³² Konventa e Vjenës mbi Marrëdhëniet Konsullore, 1963, neni 23, pika 1.

³³ Neni 23, pika 2.

detyrimet e postit konsullor. Në raste të tilla, shteti dërgues duhet që të tërheq emërimin e tij.³⁴

Në tre rastet e përmendura më lartë, shteti pritës nuk është i obliguar që të tregojë arsytet lidhur me vendimet e tij.³⁵

2.3 Imuniteti për shkak të tërheqjes së ekzekvaturës

Përveç në rastet e tërheqjes së ekzekvaturës ose të prishjes së marrëdhënieve konsullore, atëherë konsulli do të lëshojë funksionin e tij në kohë dhe me të njëjtën rutinë sikurse kur ka arritur. Në veçanti, ai i njofton autoritetet lokale nëse ndodhë një rast i tillë dhe njëkohësisht emëron një person të cilit do t'i besohet administrimi i çështjeve deri në ardhjen e një shefi të ri.³⁶ Ashtu siç përmendëm pak më lartë, në rast se shteti dërgues refuzon ose nuk përmbush detyrimet e veta brenda afatit të arsyeshëm, shteti pritës ka mundësi që në përputhje me rrethanat të tërheq ekzekvaturën për personin në fjalë ose të pushojë ta konsiderojë atë si anëtarë i personelit konsullor.³⁷

2.4 Imuniteti për shkak të konfliktit të armatosur

Në rast të konfliktit të armatosur, Konventa e Vjenës parasheh që shteti pritës duhet t'u sigurojë kohë të mjaftueshme anëtarëve të personelit të konsullatës për të përgatitur largimin e tyre nga vendi. Ai gjithashtu duhet t'u vë në dispozicion mjetet e transportit të cilat janë të nevojshme për ta dhe pronën e tyre.³⁸ Prandaj, edhe në Konventën e Vjenës mbi Marrëdhëniet Konsullore thuhet: *“Shteti pritës është i obliguar edhe në rast të konfliktit të armatosur t'u mundësojë anëtarëve të postit konsullor dhe anëtarëve të stafit privat, përveç shtetasve të shtetit pritës dhe anëtarëve të familjes së tyre të cilët jetojnë në të njëjtën shtëpi pavarësisht shtetësisë, kohën dhe lehtësimet të cilëve u janë të nevojshme për përgatitjen e largimit të tyre dhe të lëshojnë territorin brenda afatit të arsyeshëm pas përfundimit të funksioneve të tyre. Në veçanti, në rast nevoje shteti pritës është i obliguar që t'u sigurojë mjetet e*

³⁴ Neni 23, pika 3.

³⁵ Neni 23, pika 4.

³⁶ Wood, J. R. & Serres, J. Diplomatic Ceremonial and Protocol-Principles, Procedures & Practices, London & Basingstolee, 1970, f. 78.

³⁷ Konventa e Vjenës mbi Marrëdhëniet Konsullore, 1963, neni 23, pika 2.

³⁸ Wood, J. R. & Serres, J. Diplomatic Ceremonial and Protocol-Principles, Procedures & Practices, London & Basingstolee, 1970, f. 78.

*transportit për ta dhe pasurisë së tyre, përveç pasurisë së fituar në shtetin pritës, bartja e së cilës është e ndaluar në kohën e largimit të tyre”.*³⁹

2.5 Heqja dorë nga posti konsullor

Forma më e zakonshme e përfundimit të imuniteteve konsullore është heqja dorë nga posti konsullor, por është vështirë të kërkohet ndonjë shpjegim pasi që zyrtarët konsullor të karrierës gjatë kryerjes së shërbimeve të tyre transferohen nga një post në tjetrin. Ata gjithashtu mund të tërhiqen nga shteti dërgues për arsye të tjera dhe në të gjitha këto raste funksionet e zyrtarit përfundojnë sapo qeveria e shtetit pritës të informohet për një transferim ose pension të tillë nga shteti dërgues. Sa u përket shefave konsullor, shteti pritës zakonisht njoftohet përmes kanalit diplomatik sipas kërkesës për dhënien e ekzekvaturës për pasardhësin e tij. Në rastet e zyrtarëve të tjerë konsullor, njoftimi dërgohet nga shefi konsullor.⁴⁰

2.6 Imuniteti në rast të vdekjes së konsullit

Është më se e qartë se vdekja zyrtarit konsullor sjell deri në përfundimin e statusit të tij konsullor. Ashtu siç është përmendur deri më tani pavarësisht vdekjes së konsullit, anëtarëve të familjes së tij u lejohej të gëzojnë imunitetet dhe privilegjet deri në largimin e tyre nga territori e shtetit pritës ose deri në kalimin e afatit të arsyeshëm pas vdekjes së zyrtarit konsullor.⁴¹ Prandaj, në rast të vdekjes së ndonjë anëtari të postit konsullor, anëtarët e familjes së tij ose ata të cilët jetojnë në të njëjtën shtëpi i gëzojnë të gjitha imunitetet dhe privilegjet deri në momentin e lëshimit të shtetit pritës ose deri në kalimin e afatit të arsyeshëm, i cili u mundëson ta bëjnë një gjë të tillë sa më shpejtë të jetë e mundur.⁴² Gjithashtu, mund të përmendet se në rast të vdekjes së ndonjë anëtari të konsullatës ose të ndonjë anëtari të familjes së tij, shteti pritës është i obliguar që të lejojë eksportin e pasurisë së luajtshme të të ndjerit, me përjashtim të ndonjë pasurie të tillë të fituar në shtetin pritës, eksporti i së cilës ishte i ndaluar në kohën e vdekjes së tij. Gjithashtu, shteti pritës nuk mund të vendosë tatim mbi pasurinë, trashëgiminë ose

³⁹ Konventa e Vjenës mbi Marrëdhëniet Konsullore, 1963, neni 26.

⁴⁰ Sen. B. A. Diplomat's Handbook of International Law and Practice, The Hague, 1965, f. 270.

⁴¹ Po aty, f. 272.

⁴² Konventa e Vjenës mbi Marrëdhëniet Konsullore, 1963, neni 53, pika 5.

detyrime nga trashëgimia mbi pronën e luajtshme, gjetja e së cilës në shtetin pritës ishte për shkak të të ndjerit si anëtar i konsullatës ose si anëtarë i familjes së ndonjë zyrtari ose punonjësi konsullor.⁴³

2.7 Pushimi i ekzistimit të shtetit

Siç mund të shihet statusi konsullor përfundon me pushimi e ekzistimit të shtetit dërgues ose të shtetit pritës, sepse statusi konsullor krijohet me anë të emërimit dhe dhënies së ekzekvaturës. Prandaj, me humbjen e sovranitetit të shtetit pritës përfundon edhe statusi konsullor, përveç në rastet kur merret ndonjë ekzekvaturë e re ose ndonjë autorizim i përkohshëm nga shteti i cili ka absorbuar shtetin pritës. Sidoqoftë, humbja e sovranitetit të shtetit dërgues, në asnjë rast nuk i jep fund statusit konsullor, veçanërisht në rastet kur absorbimi i shtetit dërgues nga ndonjë shtet tjetër nuk njihet nga shteti pritës. P.sh. Shtetet e Bashkuara, vazhduan të njohin statusin konsullor të konsujve estonezë, letonezë dhe lituanezë, pasi integrimi i këtyre shteteve në Bashkimin Sovjetik nuk ishte i njohur nga Shtetet e Bashkuara. Sidoqoftë, kjo është e natyrës përjashtuese. Në rastet kur si rezultat i ndonjë lufte ose *coup d'état*⁴⁴ shteti pritës kalon në duart e ndonjë qeverie e cila nuk njihet nga shteti dërgues, atëherë lind pyetja nëse statusi konsullor i konsujve të shtetit dërgues mund të vazhdojë. Është e qartë se qeveria e cila nuk njihet ka mundësi që me veprimin e saj të përfundojë një status të tillë, por nga ana tjetër konsulli mund të vazhdojë të kryejë funksionet e tij nëse i lejohet ta bëjë këtë nga regjimi i cili nuk njihet nga shteti dërgues.⁴⁵

Conclusion

Diplomatic and consular immunity is of particular importance in all diplomatic relations. Their significance is especially evident when it comes to terminating diplomatic and consular immunity, for which the conventions are safeguarded, which provides such protection similar to that provided for diplomatic and consular representatives.

Based on the cases mentioned above, which relate to the termination of diplomatic and consular immunity and privilege, namely, the diplomatic representative's waiver of diplomatic immunity, it is crucial

⁴³ Sen. B. A. Diplomat's Handbook of International Law and Practice, The Hague, 1965, f. 272.

⁴⁴ Ky term e ka kuptimin e "grusht shtetit".

⁴⁵ Sen. B. A. Diplomat's Handbook of International Law and Practice, The Hague, 1965, 272-273.

that the diplomatic representative adheres to the Vienna Convention, which emphasizes that if he decides to resign, he must do so explicitly. However, it happens a little differently in cases of declaring someone non-grata. It means that the receiving state can declare the person, either as a diplomatic or consular representative, non-grata at any moment without giving any reasons for such a decision.

Therefore, the issue of diplomatic and consular relations remains an important topic in diplomatic relations, and aside from its the political significance, it is important to pay attention to the institutional aspect that is based on both internal rules and international laws.

Recensentë:

Prof. dr. Altin Shegani

Prof. dr. Bujar Ahmedi

Literatura e shfrytëzuar:

Libra

- Aust, A. Handbook of International Law, Cambridge, 2010.
- Grant, J. P. & Barker, J. C. International Criminal Law Deskbook, Sydney & London, 2006.
- Gruda, Z. E drejta ndërkombëtare publike, Prishtinë, 2003.
- Марковски, Д. Дипломатија - организација, Скопје, 2016.
- Sen. B. A. Diplomat's Handbook of International Law and Practice, The Hague, 1965.
- Wood, J. R. & Serres, J. Diplomatic Ceremonial and Protocol-Principles, Procedures & Practices, London & Basingstoke, 1970.
- Вуд. Ц. Р. & Серес. Ц. Дипломатски церемонијал и протокол, Скопје, 2009.

Dokumente ndërkombëtare

- Konventa e Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike, 1961.
- Konventa e Vjenës mbi Marrëdhëniet Konsullore, 1963.
- Konventa e Vjenës mbi të Drejtën e Traktateve, 1969.

Të tjera

- Shënime nga intervista me ish-ambasadorin Arben Çejku, të realizuar në datën: 03.02.2022.